

RAPORT TEKNIK

PROJEKT ZBATIMI

”SISTEMIM ASFALTIM RRUGA ”PALVAR”



PROJEKTOI:

“NOVATECH STUDIO” sh.p.k.

I.Veshtrim i pergjithshem


Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Malësia e Madhe është krahinë e trojeve shqiptare e cila shtrihet në lindje të Podgoricës dhe përbri Liqenit të Shkodrës e deri në Kosovë. Shkëmbinjtë gëlqerorë që mbizotërojnë këtu dhe reshjet e vogla i kanë përcaktuar kësaj krahine një fizionomi të thatë dhe të zhveshur. Në tërë këtë hapësirë rrjedh lumi i Cemit, i cili buron nga Alpet Shqiptare dhe derdhet në Moraçë. Në pjesën e epërme ka një rrjedhë të shpejtë e të vrullshme, ndërsa lugina është e thellë dhe e ngushtë. Me të dalë në fushën e Cemit ai zgjeron shtrati e vet dhe fiton tiparet e lumit fushor me rrjedhje më të ngadalshme, me luginë të cekët dhe me shumë gjarpërime.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia e Malësisë së Madhe është 30,823 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil ajo përfshin 53,918 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 951.01 km² me një densitet prej 56.69 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 32.41 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Ndarja administrative: Malesia e Madhe përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Kopliku, Gruemira, Kastrati, Kelmendi, Qendra dhe Shkreli. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Koplik dhe Bajzë) dhe 56 fshatra.

II.Hidrologjia



2.1 Kushtet Klimatike

Kjo zone sipas ndarjes klimatike të Shqipërisë bën pjesë në dy zona klimatike: Mesdhetare kodrinore nën zonë juglindore dhe në zonën Mesdhetare malore nën zonë veriore, e cila karakterizohet nga një mot me dimër relativisht të fortë dhe të lagët dhe verë të nxehtë pothuajse të thatë. Reshjet bien kryesisht në formë shiu por edhe rënie e bores është e shpeshtë dhe në sasi të konsiderueshme në periudhën e ftohtë të vitit.

Me të gjithë sipërfaqen relativisht të kufizuar, në zonën në studim paraqiten të gjitha format e relievit (male, kodra, fusha dhe lugina). Si rrjedhim, në këtë zonë shfaqen ndryshueshmëri të konsiderueshme të parametrave klimatologjike.

2.2 Rrezatimi diellor dhe diellzimi

Nga përpunimi i te dhënave shume vjeçare rezulton se sasia vjetore e rrezatimit te përgjithshëm diellor arrin vlerën e 1538.4 Kwh/m². Nga ecuria nder vjetore e këtij elementi, shihet se vlera me e larte e tij arrihet ne korrik (210.9 Kwh/m²) dhe ajo me e ulet ne dhjetor (47.2 Kwh/m²).

Kjo zone, ashtu si edhe ne rastin e rrezatimit diellor, karakterizohet nga një numër i madh i orëve me diell. Mesatarisht gjate vitit ka 2457 ore me diell, me vlerën me te larte ne korrik me 349 ore dhe atë me te ulet ne dhjetor me 92 ore.

2.3 Regjimi i temperaturës se ajrit

Siç e përmendem edhe me sipër, pozicioni gjeografik dhe format e ndryshme te relievit reflektohen ndjeshëm ne kushtet klimatike te zonës dhe sidomos ne regjimin e temperaturave te ajrit. Një përfytyrim te përgjithshëm te regjimit termik te një zone e jep shqyrtimi i vlerave mesatare vjetore te temperaturës. Konkretisht, temperaturat mesatare variojne nga vlera 5.20C për muajin me te ftohte (janar) deri ne 23.60C ne muajin korrik, ndërsa vlerat maksimale shkojnë nga 10.00C ne janar deri ne

31.90C ne korrik – gusht.

Temperatura mesatare minimale varion nga 0.40C ne janar deri ne 15.30C ne korrik. Ekstremet absolute ne këtë zone janë relativisht te theksuara. Kështu vlera minimale absolute e temperaturës se ajrit për te gjithëperiudhën e regjistrimit është – 17.4 C (27 dhjetor 1986) ndërsa ajo maksimale arrin ne +42.6 C

2.4 Reshjet atmosferike

Kjo është një nga zonat qe karakterizohet nga një sasi reshjesh vjetore te larta, te cilat janë 30% mbi mesataren e përgjithshme te vendit. Për shkak te veprimtarisë se gjere ciklonare, reshjet me te shumta vrojtohen ne gjysmën e ftohte te vitit, ndërsa ato me te ulëta ne periudhën e ngrohte te tij. Sasia vjetore e reshjeve te rena gjate vitit luhetet nga 1600 mm.

Numri iditëve me reshje > 1.0 paraqet te njëjtën ecuri me sasinë e reshjeve dhe varion nga 3.2 dite (korrik) deri ne 13.7 dite (dhjetor). Gjate vitit ka mesatarisht 102.6 dite me reshje > 1.0 mm.

Një tregues i rëndësishëm dhe idobishëmpër qëllime hidroteknike dhe urbanistike është sasia e reshjeve maksimale 24 orëshe dhe reshjet maksimale me kohëzgjatje te ndryshme për periudha te ndryshme përsëritjeje.

Vlera me e larte e maksimumit e reshjeve 24h për te gjithëperiudhën ne studim, është regjistruar ne tetor te vitit 1989 (269.8 mm) e pasuar gjithmonë nga muaji nëntor (241.9 mm) ne vitin 1962.

Vlerat e pritura te reshjeve te kësaj zone janë mjaft te larta. Konkretisht për 24 ore pritet te bien 323 mm përsigurinë 1% (periudha e përsëritjes është 1 here ne 100 vjet), ndësapërsigurinë 10%

(periudha e përsëritjes 1 here ne 10 vjet) pritet te bien 212 mm. Përsa ipërketreshjeve 1 orëshe përsiguritë e mësipërme pritet te bien përkatësisht 110 mm dhe 71 mm.

2.5 Lagështira

Vlerat e lagështirës relative luhaten nga 55% (korrik) deri ne 85% (nëntor, dhjetor), ndërsa vlera - mesatare vjetore e lagështirës është 72%.

Numri mesatar I ditëve me bore është 4.8 dite ne vit Numri mesatar iditëve me breshër është 5.7 dite ne vit. Numri mesatar I ditëve me mjegull është 33.5 dite ne vit.

III GJEOLGJIA

Në këtë kapitull do të trajtojmë përbërjen gjeologjike të zonës duke shfrytëzuar punimet ekzistuese dhe vëzhgimet e kryera në terren.

Bazuar në materialin e grumbulluar po shtjellojmë kushtet gjeologjike të ndarë në studimet ekzistuese dhe në studimet e reja të kryera së fundmi.

3.1 Studimet ekzistuese

Në zonën në fjalë janë kryer shumë studime rajonale dhe lokale, këto studime janë kryer për objektet e ndryshme që kanë të bëjnë me identifikimin e shtresave me karakteristika të dobëta dhe të zonave me qëndrueshmëri të dobët që janë prezentë në këtë rajon si dhe për projektimin e themeleve të godinave të reja industriale dhe rezidenciale që janë ndërtuar në këtë zonë.

Në lidhje studimin gjeologjik:

Janë rishikuar të gjitha punimet e mëparshme gjeologjike të kryera nga autorë vendas, të cilat janë kryer për qëllime të tjera, por kanë vlera njohëse.

Janë studiuar punimet gjeologjike të vjetra që janë kryer për zonën e qytetit . Hartat gjeologjike dhe gjeomorfologjike të zonës, ku do të ndërtohen objektet e reja.

Janë kryer disa vëzhgime të domosdoshme për të kuptuar fenomenet gjeologjike që kanë ndodhur në zhvillimin e historikut gjeologjik të kësaj zone.

Gjatë përgatitjes së Projektit do të shfrytëzohen këto studime të mëparshme si dhe eksperiencën e fituar më parë mbi projekte të ngjashme të kryera më parë në zonë.

3.2 Depozitimet e Oligocenit (Pg31)

Nën depozitimet e Kuaternarit takohen depozitimet e Oligocenit që përbëhen nga depozitime flishore; argjillite, ranore, zhavorrishte dhe alevrolite me ngjyrë gri me çimentim të dobët deri mesatar, pjesa e sipërme e këtyre depozitimeve është e përajruar. Këto depozitime dalin në sipërfaqe në zona të caktuara.

3.3 Kushtet Hidrologjike

Nga studimet e kryera (nga matjet e kryera në shpimet për disa vite në punimet e ndryshme që janë kryer për këtë zonë) rezulton se niveli i ujit nëntokësor në dimër dhe në verë është pothuajse i ndryshëm. Për këtë studim janë shfrytëzuar punimet ekzistuese dhe punimet e reja në to, janë kryer matje në disa kohë gjatë periudhave të ndryshme dhe rezulton se në pjesën më të madhe të zonës niveli i ujërave nëntokësor nuk është afër sipërfaqes së tokës dhe varion nga thellësia 8m deri në

10m. Por gjatë momentit të reshjeve intensive ka nivel të përkohshëm të ujërave nëntokësor.

Në këtë fazë konsulenti është limituar në studimin e përgjithshëm të zonës duke bërë vizita në terren dhe duke propozuar zgjidhje teknike të cilat janë në favor të sigurisë rrugore dhe investimit që do kryhet për këtë segment.

Nga analizat e kryera rezulton se janë ujëra neutralë dhe nuk janë agresivë ndaj hekurit dhe betonit. Prania e detit e bën këtë zonë agresive ndaj elementeve të ndërtimit, për këtë arsye betonet duhet të

jenë konform kërkesave për zona të tilla.

3.4 Karakteristikat e dherave dhe të shkëmbinjve

Materialet në shtratin lumor përbëhen nga zhavorre dhe rëra të zakonshme, me elemente të grimcuar me natyrë kryesisht gëlqerore dhe kanë një formë të rrumbullakët.

Tarracat lumore përbëhen nga depozita të lirshme zhavorri dhe rëre, me shtresa lymore- ranore. Forma e pjesëzave të rrumbullakosur, me forme lymore- ranore dhe shpërndarja madhësisë së grimcave është e karakterizuar nga një ndryshueshmëri të lartë; qëndrueshmëria është veçanërisht e ndryshueshme si në drejtimin vertikal ashtu dhe në drejtimin horizontal.

Depozitat e vendosura përgjatë deltes aluviale tregojnë një densitet të dukshëm, me shtresa të rastësishme të çimentuara, lymore - ranore; elementet klasike janë heterogjene në madhësi dhe me forma këndore. Fuqia mekanike e kësaj depozite varet nga shkalla e ngjeshjes natyrore dhe supozohet të jetë shumë e ndryshueshme midis shtresave të ndryshme. Ky material mund të përmbajë në disa vende një fraksion të dukshëm grimcash të vogla (lym, argjile) i cili i jep materialit

një plasticitet të moderuar dhe kohezion në dukje. Përshkueshmëria është përgjithësisht nga “mesatare” në “e lartë”, duke u ulur herë pas here nga prania e grimcave të imta.

IV.MJEDISI

Ky kapitull përshkruan masat zbutëse të projektuara për të shmangur ose ulur ndikimet negative mbi mjedisin natyror dhe peizazhin.

Në të gjitha zonat ku kemi gjurmime apo mbushje të konsiderueshme, në projekt do të parashikohen skarpata të gjelbëruara dhe pemë për të minimizuar sa më shumë impaktin e projektit në ambjent. Në krahun e djathtë mund të realizohen disa pemë dekorative dhe shkure të gjelbërta për një periudhë sa më të gjatë të vitit.

Gërmimet në zonë do të jenë minimale, për arsye se terreni nuk është i thyer dhe skarpatat janë relativisht të ulëta, në pjesën fundore kemi nga ana e majtë formacione shkembure të paveshura të cilat në ndërtimin e rrugës duhet të jenë të pajisura me mure pritës për të penguar kalimin e inerteve në rrugë.

Kalimi në zonën e gjelbërt, në fushë do të bëhet në të njëjtën kuotë me terrenin ekzistues, kjo për të ulur impaktin mbi gjelbërimin e zonës.

Masat konsistojnë në gjelbërimin përgjatë rrugës, rimbjellja e skarpateve në mbushje (në zonat kur kemi te tilla).

Këto veprime do të kenë dobi të dyfishtë për të përmirësuar pamjen dhe kompensimin për çdo bimë dhe pemë të shkatërruara gjatë pastrimit të terrenit ku ndërtohet rruga.

V.Vendodhja e rruges dhe gjendja ekzistuese

Rruga e Palvarit shtrihet në jug të qytetit të Koplikut, në veri të perroit të Banushit në koordinatat

Lat. 42°11'57.63"N deri në Lat. 42°12'27.63"N

Long. 19°26'59.08"E Long. 19°27'25.41"E

Rruga në fjalë realizon hyrjen në fshatin e Palvar-Bogic-it, me sakte në zonën e Palvarit.

Akresi në rrugë është i realizueshëm nepermjet hyrjes në rrugën e qytetit të Koplikut.

Gjatesia e rruges është 1170 m dhe gjerësia varion nga 2.9 deri në 6.8m .



Albania

Rruga paraqitet e asfaltuar me nje gjeresi $B=3\text{m}$ per 400m e para.Me tutje nuk ka shtresa asfaltike,bazamenti paraqitet mesatarisht I forte,por shtresat e siperme lene per te deshiruar. Rruga eshte nen veprimin e rrekeve siperfaqsor te shkaktuar nga agentet atmosferike. Pjesa e asfaltuar eshte amortizuar ne seksione te caktuara,po per shkak te mosmenaxhimit te ujrave siperfaqsores.



VI. Investimi i parashikuar

Investimi parashikon rehabilitimin e pjesshem e asfaltit ekzistues, germimin e trupit te rruges, shtrimin me zhavorr lumi, shtrimin me shtresat perkatese asfaltike , mbrojtjen e skarpatave si dhe disiplinimin e ujrave siperfaqsove rrugen e Palvarit. Gjeresia mesatare e asfaltit do te jete 4m me perjashtim te zonave ku nuk eshte e mundur arritja e kesaj gjeressie per shkak te skarpatave

VI. Profilat e parashikuar

Projekti ndahet ne 8 profile tip , te cilet kane gjatesite si me poshte

Profili tip 1 L=395ml Pr000-Pr395;Pr1070-Pr1080

Asfalti ekzistues do te prihet dhe ne krahun e djathte ne drejtim te veriut do te profilohet rruga me 3 shtresa me nje gjeresi 1m. Shtresat do te jene zhavorr 15cm, stabilizant 10cm, binder 6cm. Rruga ne te djathte do te mbyllet me kunete b=50cm dhe bordure 15x30cm, ne menyre qe te behet disiplinimi i ujrave siperfaqsove.

Profili tip 2 L=51ml Pr480-Pr509;Pr538-Pr560

Rruga nuk ka shtresa asfaltike. Parashikohet germim kasonete ,dhe shtrim me 3 shtresa perkatesisht: zhavorr 15cm, stabilizant 10cm, binder 6cm. Ne te majte parashikohet bankine 50cm, shtresa asfaltike do te kete gjeressine 4m. Rruga do te ndertohet me nje pjerresi dhe do te mbyllet ne te djathte me kunete 50cm dhe bordure, ne menyre qe te realizohet disiplinimi i ujrave siperfaqsove.

Profili tip 3 L=114ml Pr395-Pr480;Pr50-Pr538

Parashikohet germim kasonete ,dhe shtrim me 3 shtresa perkatesisht: zhavorr 15cm, stabilizant 10cm, binder 6cm. Ne te majte parashikohet bankine 50cm, shtresa asfaltike do te kete gjeressine 4m. Rruga do te ndertohet me nje pjerresi dhe do te mbyllet ne te djathte me kunete 50cm dhe bordure, ne menyre qe te realizohet disiplinimi i ujrave siperfaqsove. Ne te djathte parashikohet trotuar me lluster betoni me gjeresi variabel.

Profili tip 4 L=5ml Kryqezimi Pr540

Parashikohet germim kasonete ,dhe shtrim me 3 shtresa perkatesisht: zhavorr 15cm, stabilizant 10cm, binder 6cm. Ne te majte parashikohet bankine 50cm, shtresa asfaltike do te kete gjeressine 4m. Rruga do te ndertohet me nje pjerresi dhe do te mbyllet ne te djathte me kunete 50cm dhe bordure, ne menyre qe te realizohet disiplinimi i ujrave siperfaqsove. Ne kryqzime kuneta do te jete e luget, me dy pjerresi si dhe hyrjet e kryqzimeve do te profilohen me shtresat e nevojshme.

Profili tip 5 L=132ml Pr560-Pr692

Parashikohet germim kasonete ,dhe shtrim me 3 shtresa perkatesisht: zhavorr 15cm, stabilizant 10cm, binder 6cm. Rruga do te kete gjeressine 4m shtresa asfaltike+2x0.5m bankina te karikuara me stabilizant me 2 pjerresi. Ne baze te azhornimit ne vend rruga nuk paraqet probleme ne disiplinimin e ujrave siperfaqsove.

Profili tip 6 L=160ml Pr592-Pr852

Karakterizohet nga gjerësi jo shumë e madhe e kufizuar nga skarpata relativisht të buta. Parashikohet germim kasonete, dhe strim me 3 shtresa perkatesisht: zhavorr 15cm, stabilizant 10cm, binder 6cm. Rruga do të ketë gjerësi 3.5m shtrese asfaltike, 1m bankine dhe karikim dhe sistemim skarpatash në të dyja anët e rrugës.


Profili tip 7 L=218ml Pr852-Pr1070

Nga karakteri i rrugës është e nevojshme të ndërtohet një kanal betoni me $b=40\text{cm}$, $h=40\text{cm}$ në të majtë të rrugës. Parashikohet germim kasonete, dhe strim me 3 shtresa perkatesisht: zhavorr 15cm, stabilizant 10cm, binder 6cm. Rruga do të ketë gjerësinë 4m me bankine në të djathtë 50 cm. Në të majtë parashikohet kune të 50 cm e cila do të disiplinojë ujërat sipërfaqësore në kanal. Rruga parashikohet me një pjerrsi.

Profili tip 8 L=60ml Pr1080-Pr1140

Parashikohet skarifikimi dhe riveshja e asfaltit ekzistues në gjerësinë 4m si dhe karikimi i bankinave anësore me stabilizant.





VII Udhezime

Për të gjitha punimet do të respektohen rregullat e sigurimit teknik si dhe standardet e kushtet teknike:

Do të respektohen standardet e prodhimit dhe shtrimit për asfaltobetonin, binderin si: koha, lagështia dhe rregullat e ngjeshjes etj.

E njejta problematike si me lart duhet respektuar dhe edhe për nenshtresat rrugore.

Do të respektohen edhe kushtet teknike dhe standardet e punimeve të tjera me beton, të gërmimeve, skarifikimeve, etj.

Në zonen ku ka levizje të mjeteve do të organizohet levizjes me shenja rrugore speciale dhe pajisje të nevojshme.

Për të gjitha punimet do të mbahet dokumentacion i plote teknik duke përfshirë dhe provat laboratorike.

VIII. Projekti permban:

1. Raportin Teknik
2. Specifikimet teknike
3. Preventivin e punimeve
4. Vizatimet, ku perfshihen
5. Planimetria e pergjitheshme, perfshi rilevimin ne shkalle
6. Profilat gjatesore
7. Profilat terthore te detajuar
8. Profilat terthore tip
9. Detajet e bordure, kunete, mur mbajtes
10. Nje CD ku gjendet i gjithe materiali ne forme elektronike

Projekti dhe preventivi nuk perfshin sinjalistiken.

Te gjitha keto materiale ruajne te drejten e autorit (COPY RIGHT) dhe perdorimi ose shperndarja e tyre nuk u lejohet personave te paautorizuar.

PROJEKTO I

“NOVATECH STUDIO” sh.p.k

